

FTESE PER OFERTE

Prodhim të videove ndërgjegjësuere dhe infografeve

Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”

Instituti e Studimeve Politike (ISP), do të implementojë projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit(KSHH) organizatë lider si dhe në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare(QQ).Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ISP hap thirrjen për angazhimin e një subjekti /eksperti për prodhimin e videove ndërgjegjësuere dhe infografeve.

ISP inkurajon aplikimet nga subjektet dhe kandidatët, të cilët janë të interesuar dhe merren me prodhimin e këtyre produkteve të dërgojnë nje oferte financiare

Procesi i përzgjedhjes

Përzgjedhja e aplikantit/subjektit më të favorshëm do të jetë e brendshme dhe vendimi do të merret nga një komision vlerësimi prej 3 anëtarësh. Aplikantët mund të paraqesin çdo pyetje shtesë dhe/ose kërkesë për sqarime në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com.

Subjektet/ekspertët e interesuar janë të lutur të japin ofertat e tyre që të dërgojnë deri në datën 25.01.2023, ora 12.00 në formë elektronike në adresën e e-mailit të ISP contactaips@gmail.com, me postë ose dorazi me zarf të mbyllur me mbishkrim sipër zarfit: “Ofertë për video dhe infografe” në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Ofertë financiare në GBP dhe produktet e ndara
- Shembuj të punëve të mëparshme
- Cmimi ofruar të jetë në GBP me vlerë totale përfshirë TVSH

ato subjekte/eksperte të interesuara që përmbushin kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të regjistruara pranë QKB –per subjekte
- Te jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike.
- Çmimi të përfshijë dhe TVSH -në.
- Faturat pranohet vetem të fiskalizuara.
- Preferohen subjekte që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë

Specifikimet teknike :

- Video do të jetë në gjuhën shqipe dhe me titra në gjuhën shqipe.
- Kohëzgjatja duhet të jetë 1’ - max 2 minuta
- Me titra
- Ilustim me animacione
- Sasia 3 copë video dhe 20 infografe
- Si per videot dhe per infografiket materiali i brendshem do te pergatitet në bashkpunim me stafin e ISP

Periudha e prodhimit të videove është 2 videot e para per muajin shkurt dhe video e tretë në qershor, me fond limit është 2700 GBP për videot ne total. Fondi limit për infografiket është 2000 GBP gjithë periudhën e angazhimit.

Lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti. Vetëm subjekti i përzgjedhur do të lajmërohet pas procedurës së përzgjedhjes.

Sinqerisht,
Instituti i Studimeve Politike